

AKT- THEMELIM

I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TE KUFIZUAR

"TIRANA DUE" SHPK.



Personi që krijon këtë shoqëri:

EDMOND TOLE i biri i Leonidhës, lindur në Korçë më 1.09.1948, banues në Tiranë Rruga "Qemal Stafa" P.343, Sh.5, Ap.11, me pasaportë nr. 0566603, me kombësi dhe shtetësi shqiptare, ka hartuar këtë akt-themelimi për krijimin e një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar.

Në mbështetje të ligjit Nr 7512 datë 10.8.1992 "Për sanksionimin dhe mbrojtjen e pronës private dhe të shtetit në lire" dhe të ligjit Nr.7639 datë 19.11.1992 "Për shoqëritë Tregëtare", në ortakun i vetëm Edmond Tole vendosa, krijimin e Shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar, për të zhvilluar aktivitet privat.

Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar emërtohet "TIRANA-DUE" SHPK, dhe ka për objekt të veprimtarisë së saj:

-Import-export; konstruksione metalike, impiante për thyerje larje, sitje dhe transportim e tregëtim i asortesh e pjese për to.

Kapitali themelues i shoqërisë do të jetë 100.000 lekë (njëqind mijë lekë), të deponuara në një nga bankat e Shqipërisë, në një llogari rrjedhese të celur në emër të shoqërisë, para fillimit të veprimtarisë së saj.

Dorëzimet e aktivitetit të shoqërisë do të jetë më 10 vjet.

Selia e shoqërisë do të jetë në Tiranë, me adresë: Rruga "Qemal Stafa" Pallati 343 Shk.5 Ap.11.

Administrator i shoqërisë do të jetë z.Edmond Tole.

Përfaqësimi ndaj të treta do të bëhet nga administratori i shoqërisë.

Konfliktet që mund të lindin gjatë aktivitetit të shoqërisë do të zgjidhen në Gjykatën e rrethit Tiranë.

Viti i parë financiar fillon nga data e rregjistrimit të shoqërisë dhe mbaron më 31 dhjetor 1999. Çdo vit tjetër financiar fillon nga 1 janari dhe përfundon më 31 dhjetor.

Qdo gjë që do të kryhet nga shoqëria, parashikohet në statutin e shoqërisë që do të depozitohet në Gjykatën e Rrethit Tiranë.

Ky akt-themelimi është hartuar në datën 7 korrik 1999 në katër kopje origjinale, duke patur faqi të barabartë ligjore.

ORTAKU I VETËM
(EDMOND TOLE)

Edmond Tole
ET


REPUBLIKA E SHQIPËRISE
DHOMA E NOTERISE TIRANE

Nr 1374 Rep.

Nr 182 Kol.

VERTETIM

Sot në Tiranë, në datën 28.07.1999, në zyrën e notarisë Tiranë, u paraqit personalisht para meje noteres Ortaku i vetëm i Shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar "TIRANA DUE" SHPK, z. Edmond Tole, me identitetin e mësipërm, i cili në deklaroni se Akti i Themelimit të mësipërm, është hartuar me vullnetin e tij të lire dhe të plotë; dhe unë noterja duke e gjetur atë konformë ligjit e vertetëtoj.



NOTERE
Edmond Tole
Edmond Tole

STATUT

I SHOQËRISE ME PËRGJEGJESI TË KUFIZUAR

"TIRANA DUE"-SHPK.



Personi që krijon këtë shoqëri:

EDMOND TOLE, i biri i Leonidhës, lindur në Korçë më 1.09.1948, banues në Tiranë Rruga "Qemal Stafa" P.343, Shk.5, Ap.11, me pasaportë Nr-0566603, me kombësi dhe shtetësi Shqiptare, ka hartuar si më poshtë statutin e një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar, të cilën ai ka vendosur që t'a themelojë.

1

HYRJE

- 1.1 Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar "TIRANA DUE" SHPK, krijohet mbi bazën e iniciativës së lire dhe kapitalit themeltar të ortakut të vetëm Edmond Tole, me banim në Tiranë.
- 1.2 Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar "TIRANA DUE" SHPK, krijohet dhe e zhvillon aktivitetin e saj, në përputhje me të gjithë rregullat e kësaj statuti dhe të legjislacionit në fuqi të Republikës së Shqipërisë.
- 1.3 Kjo shoqëri si shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, i përballon humbjet deri në kufirin e vlerës së kapitalit themeltar.

-2-

OBJEKTI

Shoqëria do të ketë objekt të veprimtarisë së saj:

-Import-Export; konstruksione metalike, impiante për thyerje larje, sitje dhe transportim dhe tregëtim inerteesh dhe pjesë për to.

3

EMRI SELIA TERITORI

- 3.1 Kjo shoqëri do të quhet "TIRANA DUE" SHPK. Shoqëria do të krijojë personalitetin e saj juridik nga data e rregjistrimit të saj në RRegjistrin Tregtar, në Gjykatën e Rrethit Tiranë.
- 3.2 Shoqëria do të ketë selinë e saj në qytetin e Tiranës me adresë: Rr. "Qemal Stafa" P.343, SH.5, Ap.11.

9/9/1990

- 3.3 Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.
- 3.4 Ajo mund të krijojë filiale të dyta dhe operative, përfundësisht apo agjensi dhe në rrethe të tjera të Shqipërisë, si dhe jashtë shtetit, në përputhje me legjislacionin në fuqi të vendit ku ato do të krijohen.

4

KAPITALI THEMELTAR

- 4.1 Kapitali themeltar i shoqërisë, përbëhet nga kontributi i ortakut të vetëm të shoqërisë, z. Edmond Toke, me një vlerë prej 100.000 (njëqind mijë) lekë.
- 4.2 Kapitali themeltar i shoqërisë është i ndarë në 100 pjesë plotësisht të shlyera me vlerë 1000 lekë secila, të renditura sipas numrit të serise nga 1 deri në 100.
- 4.3 Kapitali themeltar i shoqërisë është i depozituar në një nga bankat e Shqipërisë, në një llogari rrjedhëse, të cëluar në emër të shoqërisë, para fillimit të veprimtarisë së saj.
- 4.4 Kapitali themeltar i shoqërisë mund të shtohet apo të paksohet në varësi të rezultateve ekonomike dhe nevojave, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

5

FONDET E SHOQËRISË

- 5.1 Shoqëria për zhvillimin e aktivitetit të saj, përcakton fondet si më poshtë:
- Fondi themelor (qarkullues)
 - Fondi rezervë
 - Fonde të tjera, të cilat mund të jenë të nevojshme gjatë veprimtarisë së shoqërisë.
- 5.2 Masa e secilit fond dhe mënyra e përdorimit për secilin prej tyre, përcaktohet me vendim të ortakut të vetëm.

6

ADMINISTRATORI I SHOQËRISË

- 6.1 Shoqëria do të drejtohet nga administratori z. Edmond Toke, i cili gëzon të gjitha atributet e Asamblesë së Ortakëve të shoqërisë.
- 6.2 Raporti i administrimit, inventari dhe llogarite vjetore do të hartohen nga Administratori.
- 6.3 Administratori mund t'i delegojë kompetencat e tij.



6.4 Administratori miraton llogarite, nëse është e nevojshme pas raportit të ekspertëve kontabël të autorizuar prej tij brenda 6 muajve nga mbyllja e vitit financiar.

7

KOMPETENCAT E ORTAKUT TË VETËM

- 7.1 Vendos për ndryshimet në statut dhe miraton rregulloren e shoqërisë.
- 7.2 Vendos për politiken afariete të shoqërisë dhe përcakton fushat konkrete të veprimtarisë së shoqërisë.
- 7.3 Shqyrton bilancin vjetor, fondet e nevojshme si dhe fitimin e realizuar.
- 7.4 Vendos për krijimin e degëve dhe agjensive të shoqërisë, brenda dhe jashtë vendit.
- 7.5 Vendos për marrjen e kredive si dhe për mbarimin e shoqërisë.
- 7.6 Vendos për shndërrimin e shoqërisë nga shoqëri me përgjegjësi të kufizuar në shoqëri të llojeve të tjera.
- 7.7 Miraton ose realizon marrëdhënjet e shoqërisë me persona të tjere fizik dhe juridik.
- 7.8 Vendos për pagat e punonjësve të punësuar në këtë shoqëri.
- 7.9 Miraton një ose disa eksperte kontabël për të ushtruar kontroll mbi aktivitetin ekonomik-financiar të shoqërisë.

8

FITIMI

- 8.1 Pasi përballon detyrimet, taksat ndaj shtetit, shpenzimet e ndryshme, ortakut të vetëm i mbetet në dispozicion të tij fitimi neto.
- 8.2 Fitimi neto mund të përdoret për zgjerimin e aktivitetit për shtimin e kapitalit themeltar dhe për kapitalet në natyrë.

9


KOHËZGJATJA E SHOQËRISË

- 9.1 Kjo shoqëri krijohet krijohet me afat mbi 10 vjet.

10

MBARIMI I SHOQËRISË

- 10.1 Nëpërmëtarja e shoqërisë mbaron ose mund të shpërbëhet në çdo kohë, sipas vendimeve që do të marrë ortakut i vetëm, në rast se veprimtarja e shoqërisë nuk rezulton fitimprarëse, për shkak të forcave mëdhaore si dhe për shkaqe të tjera ligjore.



10.2 Shoqëria mund të mbarojë me anë të thithjes së saj apo të bashkimit me një shoqëri tjetër.

11

MARREDHËNJET E FUNESIMIT

- 11.1 Çdo person i punësuar në shoqëri, konsiderohet si i punësuar mbi bazën e kontratës së punës së lidhur ndërmjet tij dhe Shoqërisë në përputhje me legjislativën e punës në fuqi.
- 11.2 Çdo person i punësuar në shoqëri është personalisht përgjegjës për kryerjen e detyrës.
- 11.3 Shoqëria merrpërsipër t'i sigurojë çdo të punësuarit respektimin e ligjit dhe të rregullave të punësimit dhe të sigurimeve shoqërore.
- 11.4 Punonjësit e emëruar nuk marrin pjesë në ndarjen e fitimit.
- 11.5 Të gjithë të punësuarit në shoqëri, janë të detyruar të ruajnë sekretin e punës së shoqërisë.

12

DISPOZITA TË FUNDIT

- 12.1 Viti i parë financiar fillon nga data e rregjistrimit të shoqërisë dhe mbaron më 31 dhjetor 1999. Çdo vit financiar fillon më 1 janar dhe mbaron më 31 dhjetor.
- 12.2 Pasaria e shoqërisë mund të sigurohet në Institutin e Sigurimeve Shoqërore të Republikës së Shqipërisë.
- 12.3 Shoqëria do të ketë vullën e saj.
- 12.4 Të gjitha mosmarrëveshjet që mund të lindin gjatë ekzistencës të shoqërisë ose gjatë periudhës së likuidimit, do të zgjidhen me mirëkuptimin e palëve, në rast të kundërt, kompetente për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve është Gjykata e Rrethit Tiranë.

Ky statut është hartuar më 7 korrik 1999 në katër kopje origjinale, duke patur fuqi të barabartë ligjore.

O R T A K U I V E T Ë M

I SHOQËRISË "TIRANA DUE"-SHPK

(EDMOND TOLE)

Edmond Tole
ET